



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. 2276/Prot.
13

Pogradec, më 30.05.2024

VENDIM
Nr. 58, DATË 29/05/2024

PËR

Heqjen nga kontabiliteti, dhe lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, të vendstrehimit 8, që i korespondon pronës me numur 68 "Vëndstrehim" me vendodhje në Lagjen nr 3 Pogradec, i cili me VKM nr 1240 datë 10.09.2008 ka kaluar në pronësi të Bashkisë Pogradec.

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr.1240, datë 10.09.2008 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Pogradec, të Qarkut të Korçës", VKM nr 280 datë 15.01.1996 "Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhenien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse" të ndryshuar, shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes nr 2205/2 date 19/04/2024 me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë heqjen nga inventari ekonomik i Ndërmarrjes së Mirembajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike të vendstrehimit nr 8 qe i korespondon pronës me nr 68 me emërtimin "Vëndstrehim" me vëndodhje në Lagjia nr 3 Pogradec, mbi pasurine 2/203, 2/178, 2/116 Zona kadastrale 8582 sipërfaqja 283 m², që me VKM nr 1240 date 10.09.2008 ka kaluar në Pronësi të Bashkisë Pogradec.

2. Ngarkohet Ndermarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike, Sektori i verifikimit titujve te pronesise dhe shpronesimeve, dhe sektori Aseteve pranë Drejtorise së Financave që në zbatim të ligjit nr 10296/2010 "Per menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", Udhëzimin nr 30 datë 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën", të Ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", të kryejne veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditesimin e listës së pronave të paluajtshme dhe shirien në



[Handwritten signature]

regjistrat e pasurive të paluajteshme pranë Angjesisë Shtetërore të Kadastres Drejtoria Vendore Pogradec, të vendstrehimit nr 8 qe i perket pronës me nr 68 me emërtimin “Vëndstrehim” me vendodhje në lagjen nr 3 Pogradec.

3. Vendimi të hyjë në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 23 vota

2.Vota Pro 23

3.Vota Kundër 0

4.Vota Abstenim 0

5.Zbardhur më date 30.05.2014

